

## *Objektivat e Policisë Bashkiake për vitin 2012*

---

Veprimtaria e Policisë Bashkiake, mbështetet në kërkesat e ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për Policinë Bashkiake” dhe ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, në funksion të zbatimit të vendimeve të Këshillit Bashkiak dhe urdhërave të Kryetarit të Bashkisë.

Objektivat kryesorë të policisë Bashkiake për këtë vit janë :

- Ruajtja e rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike në përputhje me dispozitat ligjore;
- Zbatim me korrektesi i urdherave të Kryetarit të Bashkisë dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak;
- Normalizim dhe disiplinim i parkingjeve publike në qytet duke aplikuar masat shtrënguese të parashikuara në Kodin Rrugor;
- Mos lejimi i zënies së trotuarëve dhe hapësirës së gjelbërt nga shitësit ambulant;
- Kontroll dhe punë e vazhdueshme për largimin e automjeteve të ndryshëm nga trotualet;
- Mbështetje dhe bashkëpunim me drejtorin të aparatit sipas kërkesave e nevojave të tyre;
- Marrja e masave për sezonin turistik dhe ruajtja e qetësisë publike nga ndotjet akustike;
- Ngritja e grupeve të punës për eliminimin e kafshëve dhe qenve endacakë;
- Hartimi dhe përpunimi i dokumentave për aktivitete të ndryshme që do zhvillohen gjatë vitit.